

Vendim nr. 123 datë 03.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 03.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: MAJLINDA SALILLARI (MANCELLARI)

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 3 (JD), datë 15.12.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Tiranë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosnjohimit të vendimit të arsyetuar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në periudhën 1990 – 2001. Me vendimin nr. 117, datë 17.09.2001 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*vendimi nr. 117/2001 i KLD-së*), ajo është shkarkuar nga detyra për kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

2. Në datën 19.05.2016, pas pothuajse 15 vjetëve, ajo ka ngritur padi në Gjykatën e Lartë për shfuqizimin e vendimit të shkarkimit, me pretendimin se ai ishte nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji. Sipas saj, vendimit të shkarkimit i mungon tërësisht arsyetimi.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1, datë 20.01.2023, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj gjyqësor dhe dërgimin e akteve për shqyrtim Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA), pranë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*). Po kështu, edhe kërkuesja në datën 27.03.2023 i është drejtuar KPA-së me kërkesë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 117/2001 të KLD-së.

4. Pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, KPA-ja, me vendimin nr. 3 (JD), datë 15.12.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkueses, me arsyetimin se për shkak të tejkalimit të afatit ligjor ajo ka humbur të drejtën për të paraqitur ankim ndaj vendimit objekt kundërshtimi. Sipas KPA-së, megjithëse kërkuesja ka pasur dijeni për vendimmarrjen e KLD-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, me vullnetin e saj nuk ka shfrytëzuar afatin e ankimit të parashikuar në ligj, menjëherë sapo ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me gjykatën ku ka ushtruar detyrën. Po kështu, sipas KPA-së, ajo nuk ka dhënë asnjë arsye objektive për të argumentuar dhe justifikuar faktin se përse vetëm pas gati 15 vjetëve, në datën 19.05.2016, i është drejtuar gjykatës për të kundërshtuar një vendim të dhënë në datën 17.09.2001.

5. Në datën 24.04.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 29.04.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 6.1. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi KPA-ja nuk ka argumentuar se kur ligjërishit i fillonte afati i ankimit ndaj vendimit nr. 117/2001 të KLD-së, nga data e shpalljes apo nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Asaj nuk i është njoftuar vendimi i shkarkimit, që është shkelje kryesore dhe KPA-ja nuk e ka konsideruar këtë shkelje. KPA-ja nuk ka arsyetuar se si duhet të jetë akti i njoftimit, i arsyetuar apo thjesht një komunikim dhe nuk ka përmendur që vendimit të KLD-së i mungon tërësisht arsytimi, pasi ai përmban vetëm dispozitivin.
- 6.2. *E drejta për mbrojtje efektive e lidhur me të drejtën e njoftimit*, pasi vendimi i shkarkimit është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nuk i nënshtrohet efekteve të parashkrimit shues. Vendimi i shkarkimit nuk i është komunikuar individualisht si akt formal, duke i cenuar të drejtën për të paraqitur ankim. Asaj i është komunikuar vetëm dispozitivi i vendimit në atë kohë, me shkresë të ministrit të Drejtësisë, që kurrsesi nuk përfaqëson një vendim ndaj të cilit ajo mund të ushtronte ankim. Në këtë situatë, KPA-ja duhet të kishte konsideruar ankimin si të paraqitur brenda afatit ligjor. KPA-ja nuk ka vlerësuar se KLD-ja nuk ka respektuar rregullat e njoftimit të procesit dhe vendimmarrjes, të drejtat për të marrë pjesë, për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, standardin e arsytimit të vendimit, barazisë së armëve etj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

7. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të dhënë nga KPA-ja, me të cilin është vendosur mospranimi i ankimit të saj ndaj vendimit të KLD-së për shkarkimin nga detyra e gjyqtarës rreth 23 vjet më parë. Kolegji do të ndalet fillimisht në verifikimin e juridiksionit kushtetues, duke qenë se çështja lidhet me juridiksionin disiplinor të magjistratëve që i përket KPA-së.

8. Gjykata ka pohuar se neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Kjo sepse neni 131 i Kushtetutës, që

përcakton kompetencat kryesore të saj dhe neni 134, që përcakton subjektet që e vënë në lëvizje, nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, neni 140, pika 4, i Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 71, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, i jep Gjykatës kompetencën për të shqyrtuar përfundimisht ankimet e gjyqtarëve në rastet e shkarkimit nga detyra të tyre. Megjithatë, neni 179, pika 7, fjalia e dytë, i Kushtetutës, që përbën dispozitë kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, ka parashikuar se për një periudhë të përkohshme prej nëntë vjetësh nga ngritja e institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kompetenca për shqyrtimin e këtyre lloj ankimesh ushtrohet nga KPA-ja dhe jo nga Gjykata. Ndërsa, sipas pikës 5, fjalia e dytë, të nenit 179/b, po të Kushtetutës, Gjykata gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare do të funksionojë me dy kolegje, një prej të cilave është KPA-ja.

10. Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se gjatë periudhës kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, në të cilën ushtron mandatin KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të mandati kushtetues të saj juridiksioni disiplinor sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës do të ushtrohet nga Gjykata (*shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Mbi bazën e parashikimeve dhe standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji thekson se organi që ka kompetencën për të shqyrtuar dhe vendosur përfundimisht për ankimet kushtetuese të gjyqtarëve ndaj vendimeve të shkarkimit nga detyra, duke u dhënë përgjigje edhe pretendimeve me natyrë kushtetuese, është KPA-ja. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka kompetencë për shqyrtimin e këtyre lloj ankimeve. Vendimi i dhënë nga KPA-ja, e cila është një prej dy kolegjeve të Gjykatës, është pjesë e juridiksionit disiplinor të saj dhe është përfundimtar në rendin juridik të brendshëm.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se shqyrtimi i ankimit të kërkueses ndaj vendimit të KPA-së, që nuk ka pranuar ankimin e saj ndaj vendimit për shkarkimin nga detyra, nuk është në kompetencën e Gjykatës. Për rrjedhojë, kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare, sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.